



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.48

8 maj

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 279, datë 12.4.2012	Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe Albpetro- it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria “Albpetro” sh.a.)	2519
Urdhër i MPPT nr. 49, datë 30.4.2012	Për miratimin e rregullores “Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të deltaplaneve dhe parashutave”.....	2522

VENDIM
Nr. 279, datë 12.4.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË OBJEKTEVE TË OPERACIONEVE HIDROKARBURE, PJESË
E MARRËVESHJES SË LIDHUR MË 26.7.1993, NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRISË,
BURIMEVE MINERARE DHE ENERGJETIKËS (SOT MINISTRIA E EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS) DHE ALBPETROL- IT, BASHKËSISË EKONOMIKE TË
NAFTËS DHE GAZIT (SOT SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 13 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, që i bashkëlidhet marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe të Gazit (sot shoqëria “Albpetrol”, sh.a.), sipas përmbajtjes së listave “A”, “B” dhe “C” që i bashkëlidhet këtij vendimi (faqja 1 deri 5).

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E OBJEKTEVE TË KRYERJES SË OPERACIONEVE HIDROKARBURE BASHKËLIDHUR
MARRËVESHJES SË LIDHUR MË DATË 26.7.1993, MIDIS MINISTRISË SË INDUSTRISË,
BURIMEVE MINERARE DHE ENERGJETIKËS
(SOT MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS)
DHE ALBPETROL- IT, BASHKËSISË EKONOMIKE TË NAFTËS DHE GAZIT
(SOT SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA)**

1. Në listën “A” të marrëveshjes, hiqen nga lista këto objekte të kërkimit:

Vendburimet e rërave bituminoze:

- Vendburimi i Kasnicës;
- Vendburimi i Visokës;
- Vendburimi i Treblovës.

Këto vendburime i mbeten në administrim Albpetrolit vetëm për qëllim të nxjerrjes së naftës bruto dhe gazit.

2. Në listën “B” të marrëveshjes, shtohen në listë këto objekte kërkimi:

Blloku i Panajasë

1. Ndërprerja e gjerësisë gjeografike Veriore 40° 36’ 17” V me vijën bregore të detit Jon të përcaktuar me nivelin mesatar të baticës:

- 2. 40° 36’ 17” V 19° 37’ 00” L;
- 3. 40° 27’ 00” V 19° 37’ 00” L;
- 4. 40° 27’ 00” V 19° 29’ 10” L; ose

Ndërprerja e gjerësisë gjeografike veriore 40° 27’ 00” V me vijën bregore të përcaktuar me nivelin mesatar të baticës.

Blloku i Velçës:



- | | |
|------------------|----------------|
| 1. 40° 25' 00" V | 19° 37' 00" L; |
| 2. 40° 25' 00" V | 19° 43' 25" L; |
| 3. 40° 21' 00" V | 19° 43' 00" L; |
| 4. 40° 20' 00" V | 19° 45' 00" L; |
| 5. 40° 14' 00" V | 19° 58' 00" L; |
| 6. 40° 14' 00" V | 19° 37' 00" L. |

Blloku i Dumresë

- | | |
|--------------------|------------------|
| 1. 41° 00' 00.0" V | 19° 45' 00.0" L; |
| 2. 41° 00' 00.0" V | 19° 48' 00.0" L; |
| 3. 41° 05' 00.0" V | 19° 48' 00.0" L; |
| 4. 41° 05' 00.0" V | 20° 02' 00.0" L; |
| 5. 40° 50' 00.0" V | 20° 02' 00.0" L; |
| 6. 40° 50' 00.0" V | 19° 45' 00.0" L. |

3. Shtohet lista "C" me këto objekte kërkimi:

Blloku 1

- | | |
|--------------------|------------------|
| 1. 41° 30' 00" V | 20° 00' 00" L; |
| 2. 41° 30' 00" V | 20° 28' 10" L; |
| 3. 41° 05' 23.8" V | 20° 37' 59.1" L; |
| 4. 41° 00' 00" V | 20° 38' 20" L; |
| 5. 41° 00' 00" V | 20° 02' 00" L; |
| 6. 41° 05' 00" V | 20° 02' 00" L; |
| 7. 41° 05' 00" V | 20° 00' 00" L. |

Blloku 4

- | | |
|--------------------|------------------|
| 1. 40° 09' 10.0" V | 20° 41' 25.0" L; |
| 2. 40° 20' 00.0" V | 20° 30' 00.0" L; |
| 3. 40° 30' 00.0" V | 20° 30' 00.0" L; |
| 4. 40° 30' 00.0" V | 20° 15' 00.0" L; |
| 5. 40° 20' 00.0" V | 20° 15' 00.0" L; |
| 6. 40° 20' 00.0" V | 20° 00' 00.0" L; |
| 7. 40° 05' 00.0" V | 20° 00' 00.0" L; |
| 8. 39° 55' 00.0" V | 20° 15' 00.0" L; |
| 9. 39° 55' 00.0" V | 20° 20' 50.0" L. |

- Pika 1. Është ndërprerja e linjës 1-2 me linjën e kufirit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Greqisë.

- Pika 9. Është ndërprerja e paralelit 39° 55' V me linjën e kufirit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Blloku 5

- | | |
|---------------------|------------------|
| 1. 40° 27' 00.0" V | 19° 29' 10.0" L; |
| 2. 40° 27' 00.0" V | 19° 37' 00.0" L; |
| 3. 40° 14' 00.0" V | 19° 37' 00.0" L; |
| 4. 40° 14' 00.0" V | 19° 58' 00.0" L; |
| 5. 40° 20' 00.0" V | 19° 45' 00.0" L; |
| 6. 40° 20' 00.0" V | 20° 00' 00.0" L; |
| 7. 39° 57' 30.0" V | 20° 00' 00.0" L; |
| 8. 39° 52' 00.0" V | 20° 09' 40.0" L; |
| 9. 39° 55' 00.0" V | 20° 15' 00.0" L; |
| 10. 39° 55' 00.0" V | 20° 20' 50.0" L; |
| 11. 39° 38' 49.8" V | 20° 00' 31.5" L. |

- Pika 1. Është ndërprerja e paralelit 40° 27' V me vijën bregdetare të detit Adriatik në gjirin e Vlorës.

- Pika 10. Është ndërprerja e paralelit 39° 55' V me linjën e kufirit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Greqisë.

- Pika 11. Është ndërprerja me vijën bregdetare të detit Jon me vijën ndërkombëtare të kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Blloku 6

- | | |
|------------------|----------------|
| 1. 41° 00' 00" V | 20° 15' 00" L; |
| 2. 41° 00' 00" V | 20° 38' 20" L; |
| 3. 40° 09' 10" V | 20° 41' 25" L; |
| 4. 40° 20' 00" V | 20° 30' 00" L; |
| 5. 40° 30' 00" V | 20° 30' 00" L; |
| 6. 40° 30' 00" V | 20° 15' 00" L. |

Blloku 7

- | | |
|------------------|----------------|
| 1. 42° 00' 00" V | 19° 45' 00" L; |
| 2. 42° 00' 00" V | 20° 36' 30" L; |
| 3. 41° 30' 00" V | 20° 28' 10" L; |
| 4. 41° 30' 00" V | 20° 00' 00" L; |
| 5. 41° 40' 00" V | 20° 00' 00" L; |
| 6. 41° 30' 00" V | 20° 28' 30" L. |

Blloku 8

1. Ndërprerja e gjerësisë gjeografike 42° 05' 00" V me kufirin e njohur ndërkombëtarisht midis Shqipërisë dhe Malit të Zi:

- | | |
|------------------|----------------|
| 2. 42° 05' 00" V | 19° 45' 00" L; |
| 3. 42° 00' 00" V | 19° 45' 00" L; |
| 4. 42° 00' 00" V | 20° 36' 30" L. |

Blloku C

1. Ndërprerja e gjerësisë 41° 20' 00" V me vijën bregore në nivelin mesatar të baticës:

- | | |
|------------------|----------------|
| 2. 41° 20' 00" V | 19° 45' 00" L; |
| 3. 41° 00' 00" V | 19° 45' 00" L. |

4. Ndërprerja e gjerësisë 41° 00' 00" V me vijën bregore në nivelin mesatar të baticës. (Kufiri Jugor).

Bllonet e lira në det

Zona e kontratës përbëhet nga bllonet 2, 3 dhe 4 dhe "veriu i Rodonit" me koordinatat përkatëse më poshtë:

Blloku 2 (Adriatik 2)

- | | | | |
|------------------|------------------|------------------|------------------|
| a) 41° 39' 58" V | b) 41° 35' 20" V | c) 41° 35' 20" V | d) 41° 08' 30" V |
| 19° 09' 30" L | 19° 09' 30" L | 19° 09' 00" L | 19° 09' 00" L |

f) Ndërprerja e gjerësisë 41° 08' 30" V me vijat mesatare ndërmjet vijave bregdetare të Shqipërisë dhe Italisë.

g) Ndërprerja e vijave mesatare të rëna dakord midis Shqipërisë dhe Italisë dhe vijat mesatare të rëna dakord midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Blloku 3 (Adriatik 3)

- | | | | |
|------------------|------------------|------------------|------------------|
| a) 41° 08' 30" V | b) 40° 59' 00" V | c) 40° 59' 00" V | d) 40° 50' 00" V |
| 19° 09' 00" L | 19° 09' 00" L | 18° 56' 00" L | 18° 56' 00" L |

f) Ndërprerja e gjerësisë 40° 50' 00" V me vijat mesatare midis vijave bregdetare të Shqipërisë dhe Italisë.

g) Ndërprerja e gjerësisë 41° 08' 30" V me vijat mesatare midis vijave bregdetare të Shqipërisë dhe Italisë.

Blloku 4 (Adriatik 4):

- | | |
|------------------|-------------------|
| a) 40° 50' 00" V | b) 40° 25' 20" V; |
| 18° 56' 00" L | 18° 56' 00" L. |



c) Ndërprerja e gjerësisë 40° 25' 20" V me vijat mesatare midis vijave bregdetare të Shqipërisë dhe Italisë.

d) Ndërprerja e gjerësisë 40° 50' 00" V me vijat mesatare midis vijave bregdetare të Shqipërisë dhe të Italisë.

Blloku Veriu i Rodonit

1. Ndërprerja e gjatësisë gjeografike lindore 19° 23' 22" L me vijën bregore të përcaktuar me nivelin mesatar të baticës:

- 41° 45' 07" V 19° 19' 20" L;

- 41° 39' 58" V 19° 16' 48" L;

- 41° 39' 58" V 19° 09' 30" L;

- 41° 35' 20" V 19° 09' 00" L;

2. Ndërprerja e gjerësisë gjeografike veriore 41° 35' 20" V me vijën bregore të përcaktuar me nivelin mesatar të baticës.

URDHËR
Nr. 49, datë 30.4.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI KUSHTET DHE METODAT E PËRDORIMIT TË DELTAPLANEVE DHE PARASHUTAVE"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me ligjin nr. 10 484, datë 24.11.2011,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të deltaplaneve dhe të parashutave", sipas tekstit dhe shtojcave përkatëse që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

RREGULLORE
MBI KUSHTET DHE METODAT E PËRDORIMIT TË DELTAPLANEVE DHE TË PARASHUTAVE

Neni 1
Objekti

1.1 Kjo rregullore parashikon:

a) vendet për ngritjen dhe uljen e deltaplaneve dhe të parashutave;

b) rregullat dhe kufizimet për deltaplanet dhe parashutat, si dhe trajnimin, testimet, licencat dhe autorizimet e pilotëve të deltaplaneve dhe të parashutave.

1.2 Dispozitat e kësaj rregulloreje në lidhje me deltaplanet e kontrolluara kryesisht nga sipërfaqe të lëvizshme aerodinamike zbatohen gjithashtu për veloret me masë 80/100 kg.

1.3 Termat deltaplane dhe parashuta përdoren në këtë rregullore si terma të përgjithshëm të cilët mbulojnë gjithashtu deltaplanet dhe parashutat me motor.

Neni 2 Terma dhe përkufizime

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

“Pranuar/i pranueshëm” do të thotë jo i kundërshtuar nga Autoriteti, si i përshtatshëm për qëllimin e synuar;

“Aprovuar” do të thotë i dokumentuar nga Autoriteti, si i përshtatshëm për qëllimin e synuar;

“Fluturim aerobatik” do të thotë një manovrim i qëllimshëm duke përfshirë një ndryshim të menjëhershëm në lartësinë e avionit, një lartësi jo normale ose përsheptim jonormal, që nuk është i nevojshëm për fluturimin normal;

“Avion” do të thotë një makinë që mund të marrë mbështetje në atmosferë nga kundërveprimet e ajrit të ndryshme nga kundërveprimet e ajrit ndaj sipërfaqes së tokës;

“Inspektor avioni” është një person që është përgjegjës për inspektimin në lidhje me lëshimin ose rinovimin e lejes së fluturimit, në emër të Autoritetit në pajtim me standardet e parashikuara në fuqi;

“Fushë fluturimi” është aerodromi, i cili nuk ka nevojë për kufizime të një zone ndërtimi për shkak të natyrës dhe shkallës së trafikut;

“Fushë fluturimi për avionët pa motor” është një aerodrom, i cili është përcaktuar për përdorim nga mjetet fluturuese me ose pa motor, të cilat nuk janë në gjendje të ngrihen, duke përdorur motorët e tyre;

“Trajnim i aprovuar” do të thotë një trajnim i kryer sipas një programi dhe mbikëqyrjeje të veçantë të aprovuar nga Autoriteti;

“Autoriteti” do të thotë Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë i rregulluar me ligjin nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar;

“Autorizim” do të thotë vërtetimi i trajnimit shtesë për pilotët e deltaplaneve dhe të parashutave, që regjistrohet në licencën e pilotit;

“Instruktor i autorizuar fluturimi” do të thotë një pilot deltaplani dhe parashute me autorizimin e instruktorit të fundit të fluturimit, që operon brenda një organizate të aprovuar trajnimi për trajnimin e pilotëve për deltaplane dhe parashuta;

“Menaxher i autorizuar/organizator i aktivitetit të planifikuar” do të thotë personi përgjegjës për përgatitjen, organizimin, ekzekutimin dhe kontrollin e sigurt të aktiviteteve të organizuara për fluturimin me deltaplane dhe parashuta;

“Kandidat (aplikues)” do të thotë një aplikues për provim (teorik dhe/ose praktik (fluturimi)) me qëllim që të përfitohet një licencë piloti për deltaplane dhe parashuta ose një kategorizim i përshtatshëm;

“Certifikatë e trajnimit të përfunduar” do të thotë një certifikatë e një organizate të aprovuar trajnimi, për përfundimin e trajnimit teorik dhe/ose praktik të pilotëve studentë;

“Kompetencë” do të thotë një kombinim i aftësive, njohurive dhe qëndrimit që kërkohet për të kryer një detyrë sipas standardit të parashikuar;

“Hapësirë ajrore e kontrolluar” do të thotë hapësira ajrore që është njoftuar si hapësirë ajrore e Klasës A, B, C, D dhe E;

“Zonë Kontrolli (CTR)” do të thotë hapësirë ajrore e kontrolluar, që shtrihet nga sipërfaqja e tokës deri në disa limite të caktuara;

“Fluturim përtej vendit” është një tip fluturimi në distancë, që kryhet nga një avion që ndizet me këmbë, në një distancë të caktuar dhe në operacionet ndërmjet dy pikave duke përdorur teknikat navigacionale; dhe një avion pa motor (paravelore, velore) duke përdorur korrentet në ngjitje për të fituar lartësi për kohën e zgjatur të fluturimit;

“Kohë instruktimi dyfishe” do të thotë kohë e fluturimit ose kohë e marrjes së instruksioneve në një fluturim instrumental të simuluar dhe të regjistruar nga instrumenti, e cila kryhet nga një instruktor i autorizuar rregullisht;



“Ekzaminues” është një person që në emër të Autoritetit, kryen ekzaminimin praktik në lidhje me lëshimin e një licence për të operuar deltaplane dhe parashuta në pajtim me standardet e parashikuara nga AAC;

“Kohë fluturimi” do të thotë koha totale nga momenti që një avion lëviz me qëllim ngritjeje deri në momentin që pushon në fund të fluturimit;

“Regjistër i fluturimeve” do të thotë një regjistër personal i fluturimit të pilotit ose pilotit student të deltaplaneve dhe të parashutave;

“Deltaplan” do të thotë një trup aerodinamik me krahë të fiksuar në gjendje për të bërë fluturim të qëndrueshëm me vela dhe që nuk ka mjete shtyrjeje;

“Deltaplan me motor” do të thotë një trup aerodinamik me krahë të fiksuar me mjete shtytjeje, në gjendje për të bërë fluturim të qëndrueshëm me vela pa marrë shtyrje nga mjetet e shtytjes;

“Deltaplan me varje” do të thotë një deltaplan që është në gjendje të transportohet, të nisët me këmbë dhe të ulet vetëm duke përdorur këmbët e pilotit;

“Parashutë” do të thotë një velore që është në gjendje të transportohet, të nisët me këmbë dhe të ulet vetëm duke përdorur këmbët e pilotit;

“Vend uljeje” do të thotë një vendndodhje në tokë e përcaktuar për uljen e deltaplaneve dhe të parashutave;

“Deltaplan me varje me motor” do të thotë një deltaplan që është pajisur me një mjet shtyrjeje që mund ta nisë dhe ta mbajë në fluturim;

“Parashutë” do të thotë një velore me varje pa strukturë primare të fortë;

“Parashutë me motor” do të thotë një paravelore me mjetet e shtytjes në gjendje për ta nisur dhe për ta mbajtur në fluturim;

“Deltaplan në masat 80/100kg” do të thotë deltaplanet, duke përfshirë që ato që nisen me këmbë nga piloti, pesha maksimale bosh e të cilave është më pak se 80 kg për ato me një sedilje, ose 100 kg për ato me dy sedilje;

“Lëshimi (p.sh. licenca ose kategorizimi i pilotit)” do të thotë procedura administrative që kryhet gjatë vlefshmërisë së licencës ose kategorizimit që i lejon zotëruesit të licencës të ushtrojë privilegjet e dhëna nga licenca ose kategorizimi, për një periudhë të caktuar kohe, pas përmbushjes së kushteve të parashikuara;

“Lista e ekspertëve” do të thotë një listë ekspertësh nga sferat përkatëse të aktiviteteve të aviacionit që përcaktohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

“Riparim kapital” do të thotë një riparim që, sipas udhëzimeve për mirëmbajtjen kryhen vetëm nga prodhuesi ose organizata e autorizuar për të kryer inspektime teknike dhe mirëmbajtjeje;

“Fluturim i organizuar” do të thotë një fluturim me deltaplane me varje dhe parashuta për qëllimin e:

- a) një gare sportive ose ngjarjeve aeronautike;
- b) fluturimit në grup të pesë ose më shumë pilotëve të deltaplaneve me varje dhe të parashutave;
- c) trajnimit praktik (fluturimi).

“Licencë piloti-deltaplane me varje dhe parashuta” do të thotë një dokument që i jep mundësi zotëruesit të përmbushë detyrat e pilotit të një deltaplani dhe të një parashute në pajtim me autorizimet e shkruara në licencë dhe në varësi të tipit të licencës së mbajtur;

“Zonë e ndaluar” do të thotë një pjesë e hapësirës ajrore e Republikës së Shqipërisë brenda së cilës asnjë person nuk mund të operojë një avion pa lejen e Autoritetit të Aviacionit Civil;

“Aerodrom publik” do të thotë një aerodrom i certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil që në bazë të kushteve të specifikuara është i hapur për publikun;

“Rinovim (p.sh. një kategorizimi ose miratimi)” do të thotë akti administrativ i ndërmarrë pas përfundimit të afatit të kategorizimit ose miratimit që rinovon privilegjet e kategorizimit ose miratimit për një periudhë kohe të specifikuar më të gjatë, bazuar në përmbushjen e disa kërkesave të specifikuara;

“Rivleftësim (p.sh. një kategorizimi ose miratimi)” do të thotë akti administrativ i ndërmarrë

brenda periudhës së vlefshmërisë së kategorizimit ose miratimit që i lejon zotëruesit të vazhdojë ushtrimin e privilegjeve të kategorizimit ose miratimit për një periudhë kohe të mëtejshme të specifikuar, bazuar në përmbushjen e disa kërkesave të specifikuara;

“Avion sportiv” do të thotë një avion me ekuipazh fluturimi, më i rëndë se ajri, me ose pa motor (avion mikro i lehtë, deltaplan apo parashutë etj.);

“Pilot student” do të thotë një person që është i kualifikuar për përfitim të licencës së pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta;

“Vend shkëputjeje” do të thotë një vendndodhje në tokë e përcaktuar për shkëputjen e deltaplaneve me varje dhe të parashutave;

“Deltaplane me varje dhe parashuta dyshe” do të thotë një velore me varje ose paravelore e destinuar për fluturimin e njëkohshëm për dy persona;

“Regjistër trajnimi” do të thotë regjistri personal i pilotëve studentë në të cilin ata regjistrojnë lëndët e mësuara dhe observacionet për kursin e trajnimit;

“Faza e parë e trajnimit” do të thotë procesi i trajnimit të pilotëve studentë që kryhet në fillim të trajnimit të tyre gjatë fluturimit të deltaplaneve me varje dhe të parashutave, që kryejnë fluturime në lartësi të ulëta dhe të mesme;

“Faza e dytë e trajnimit” do të thotë procesi i trajnimit të kryer pas përfundimit të fazës së parë të trajnimit të pilotëve studentë në fluturimin e deltaplaneve me varje dhe të parashutave që përfundon me kalimin e provimit për përfitim të licencës së pilotit;

“Vend trajnimi” do të thotë një terren natyror ose i rregulluar për trajnimin e pilotëve studentë, që e bëjnë atë të lehtë për shkëputje, fluturim dhe ulje, pa barriera ose pengesa të tjera që mund të pengojnë ose rrezikojnë sigurinë e fluturimit.

Neni 3 Shkurtime

Shkurtime të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

AIP Publikim i informacionit aeronautik

FAI Federata Ndërkombëtare Aeronautike

Manovrim SAT (Term i sigurisë aerobatike), manovrim aerobatik në të cilin aksi i rrotullimit është ndërmjet krahut dhe pilotit

SIV (Simulation d’Incident de Vol) simulimi i incidenteve gjatë fluturimit,

VMC Kushte meteorologjike vizuale

Neni 4 Qëllimi i deltaplaneve dhe i parashutave

4.1 Deltaplanet dhe/ose parashutat përdoren vetëm në pajtim me qëllimet e parashikuara në udhëzimet e prodhuesit të velores me varje dhe paravelores.

4.2 Deltaplanet dhe parashutat përdoren për:

- a) fluturimin sportiv;
- b) gara; dhe
- c) trajnim.

Neni 5 Të drejtat dhe përgjegjësitë e pilotëve të deltaplaneve dhe të parashutave

5.1 Pilotët e deltaplaneve me varje dhe të parashutave veprojnë në pajtim me dispozitat e ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të RSH-së”, të ndryshuar, dispozitat e kësaj rregulloreje dhe çdo rregullim tjetër në fuqi në RSH për këtë qëllim.

5.2 Pilotët e deltaplaneve me varje dhe të parashutave i trajtojnë deltaplanet ose parashutat në përgjegjësinë e vet.



5.3 Pilotët e deltaplaneve me varje dhe të parashutave janë përgjegjës gjatë gjithë kohës për trajtimin dhe shërbimet e deltaplanit ose parashutës dhe për çdo pasojë që mund të rrjedhë.

5.4 Pilotët e deltaplaneve me varje dhe të parashutave marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë gjatë shkëputjes, fluturimit dhe uljes.

5.5 Pilotëve të deltaplaneve me varje dhe të parashutave u kërkohet përdorimi i rregullt i pajisjeve në pajtim me destinacionin e tyre dhe udhëzimit të prodhuesit në një mënyrë që siguron fluturimin e sigurt.

5.6 Para trajnimit ose fluturimit, instruktori i fluturimit ose piloti i dytë duhet të informojë pilotët studentë në fluturim ose pasagjerët në fluturim në lidhje me faktin që ata fluturojnë me deltaplanet ose parashutat në përgjegjësinë dhe riskun e tyre.

Neni 6

Kushtet, aprovimet dhe regjistrimet e vendeve për shkëputjet dhe uljet

6.1 Vendet e shkëputjeve dhe uljeve sigurojnë shkëputje dhe ulje të sigurt të deltaplaneve me varje dhe të parashutave.

6.2 Autoriteti mban regjistra për vendet e shkëputjeve dhe të uljeve.

Vendet e shkëputjeve dhe të uljeve përdoren për organizimin e aktiviteteve të fluturimit me deltaplane me varje dhe të parashutave, vetëm nëse Autoriteti ka lëshuar një miratim për përdorimin e tyre.

6.3 Përveç kërkesës për miratimin e vendit të shkëputjes dhe të uljes, operatori paraqet:

a) mendimin e personit nga lista e ekspertëve për përshtatshmërinë e vendndodhjes së zgjedhur për qëllimin e kërkuar;

b) pëlqimin e pronarit ose përdoruesit të tokës në të cilin ndodhet vendi i shkëputjes ose uljes;

c) aprovimin e autoritetit kompetent të bashkisë lokale;

d) nëse vendi i shkëputjes ose uljes gjendet në një pjesë të mbrojtur të natyrës (park kombëtar), mendimin e ministrit kompetente në lidhje me ndikimin që mund të ketë vendi i shkëputjes ose uljes nga këndvështrimi i mbrojtjes së mjedisit;

e) miratimin e operatorit të aeroportit, nëse vendi i shkëputjes ose uljes gjendet në zonën e aeroportit. Vendi i shkëputjes ose i uljes nuk lejohet në hapësirën ajrore të kontrolluar;

f) udhëzimet për përdorimin e vendit të shkëputjes ose uljes që përmban:

i) informacion të përgjithshëm:

- qëllimin e vendit të shkëputjes ose të uljes;

- pozicionin e vendit të shkëputjes ose të uljes;

- formën dhe madhësinë e vendit të shkëputjes ose të uljes;

- rrugët e shkuarjes te vendi i shkëputjes ose i uljes;

- emrin dhe adresën e operatorit të vendit të shkëputjes ose të uljes.

ii) shënimin e vendit të shkëputjes ose të uljes:

- vendin e shkëputjes;

- vendin e uljes.

iii) karakteristikat meteorologjike;

iv) organizimin e fluturimit:

- fluturimin në zonën e vendit të shkëputjes ose të uljes;

- vendin alternativ të uljes;

- bashkërendimin dhe menaxhimin e trafikut ajror nëse vendi i shkëputjes ose i uljes gjendet në ose pranë një aeroporti publik ekzistues.

v) siguracionin e fluturimit:

- përshkrimin e pajisjeve në vendin e shkëputjes ose të uljes, sipas rastit;

- sigurimin e ndihmës së emergjencës mjekësore;

- pajisjet e motit;

- procedurën në rast emergjence.

vi) hartat:

- harta topografike të shkallës 1: 50 000 me vendndodhjen e shënuar të vendit të shkëputjes dhe të uljes dhe zonat përkatëse për përdorimin e hapësirës ajrore;

- skicën e vendit të shkëputjes ose të uljes me një shkallë të përafërt 1: 5000.

vii) pëlqimin e Qendrës së Kontrollit të Trafikut Ajror në lidhje me pozicionet e vendit të shkëputjes dhe të uljes.

6.4 Kërkesve që përmbushin kërkesat e kësaj rregulloreje u jepet miratimi për përdorimin e vendit të shkëputjes ose uljes.

6.5 Operatori është i detyruar të bëjë një tabelë me karakteristikat e vendit të shkëputjes dhe të uljes, numrat e telefonit për njoftimin e përdorimit të tij dhe numrat e telefonit për thirrjet e emergjencës. Pilotët e deltaplaneve me varje dhe të parashutave duhet të njoftojnë operatorin e vendit të shkëputjes ose uljes dhe të kërkojnë aprovimin e përdorimit të tij.

Neni 7

Vendet e trajnimit

7.1 Pa cenuar dispozitat e nenit 6 të kësaj rregulloreje, për qëllimet e trajnimit, shkëputja dhe ulja e deltaplaneve me varje dhe e parashutave mund të bëhen në vendet e trajnimit.

7.2 Për vendet e trajnimit ku diferenca ndërmjet vendit të shkëputjes dhe të uljes është më pak se 150 m në lartësi dhe nëse piloti në kohën e fluturimit nuk është më shumë se 50 m mbi tokë, nuk kërkohet miratimi i Autoritetit.

7.3 Shkëputja ose ulja e deltaplaneve dhe e parashutave në vendet e trajnimit lejohet vetëm me pëlqimin e pronarit ose të përdoruesit të tokës.

7.4 Përdorimi i vendeve të trajnimit në një hapësirë ajrore të kontrolluar nuk lejohet.

Neni 8

Operacionet me deltaplane dhe parashuta

1. Operacionet me deltaplane me varje dhe parashutat kryhen në:

- a) kushte meteorologjike vizuale (VMC);
- b) hapësirë ajrore të pakontrolluar të Klasës C, sipas parashikimit në publikimin për informacionin aeronautik (AIP) të Republikës së Shqipërisë;
- c) zonën e aeroportit, të aprovuar paraprakisht nga operatori i aeroportit;
- d) hapësirën ajrore të kontrolluar me një autorizim të veçantë të lëshuar nga ofruesi i shërbimit të navigimit ajror.

Neni 9

Lartësitë e fluturimit

9.1 Deltaplanet dhe parashutat fluturojnë në lartësitë mbi lartësinë e sigurt minimale. Lartësia e sigurt minimale është lartësia që, në rast të një emergjence, siguron mospasjen e kërcënimeve të panevojshme për personat ose objektet në tokë ose ujë.

9.2 Deltaplanet dhe parashutat mund të fluturojnë në një lartësi prej 150 metrash (500 ft) mbi tokë ose ujë, nëse është e nevojshme për shkak të tipit të fluturimit të ofruar dhe nëse nuk ka rrezik për njerëzit dhe objektet në tokë ose ujë.

9.3 Deltaplanet dhe parashutat fluturojnë në lartësinë prej të paktën 50 metra (150 ft) mbi urat, rrugët, hekurudhat, linjat e energjisë elektrike, teleferikët, antenat dhe struktura të ngjashme dhe mbi grupet e njerëzve.



Neni 10 Kufizimet

Deltaplanet dhe parashutat ndalohen të fluturojnë:

- a) mbi zonat e deklaruara të ndaluara;
- b) në kushte të pafavorshme klimaterike;
- c) në re;
- d) në ndarje vertikale prej më pak se 150 m (500 ft) nën bazën e reve;
- e) nën ura dhe pajisje të tjera, linja transmissioni dhe antena.

Neni 11 Rregullat e fluturimit

11.1 Shkëputja:

- a) Shkëputja në hapësirën ajrore rreth pikës së nisjes duhet të jetë pa pengesa;
- b) Distanca ndërmjet dy deltaplaneve me varje dhe parashutave dhe intervali kohor ndërmjet shkëputjeve në të njëjtën pikë janë të tilla që të garantojnë shkëputjen e sigurt.

11.2 Anashkalimi:

- a) Nëse në të njëjtën lartësi ose afërsisht në të njëjtën lartësi me njëri-tjetrin fluturojnë dy deltaplane me varje ose paravelore, të dyja veloret ose paraveloret kthehen djathtas, në mënyrë që distanca ndërmjet tyre të jetë të paktën 50 metra;
- b) Nëse dy deltaplane me varje dhe parashuta fluturojnë në të njëjtën lartësi ose afërsisht në të njëjtën lartësi me njëra-tjetrën, me pjerrësi në anën e tyre, precedenca është me atë që ka pjerrësinë në krahun e djathtë të saj. Deltaplanet dhe parashutat me pjerrësi në krahun e djathtë të tyre kthehen në të djathtë të pjerrësisë për të siguruar distancën e nevojshme prej të paktën 50 metrash ndërmjet tyre.

11.3 Parakalimi:

- a) Gjatë parakalimit, ka precedencë deltaplani me varje dhe parashuta më e ngadaltë;
- b) Nëse një deltaplan me varje dhe parashuta që fluturon me një shpejtësi më të madhe ajrore has afërsisht në të njëjtën lartësi një velore tjetër me varje apo paravelore që fluturon në të njëjtin drejtim me shpejtësi ajrore më të vogël, ajo mund ta parakalojë duke u kthyer djathtas;
- c) Deltaplanet dhe parashutat nuk parakalojnë një velore me varje ose paravelore tjetër afër pjerrësisë nëse pjerrësia gjendet në të djathtë sipas drejtimit të fluturimit;
- d) Nëse pjerrësia është në anën e majtë në lidhje me drejtimin e fluturimit, parakalimi lejohet, me kusht që velorja me varje ose paravelorja që fluturon me një shpejtësi më të lartë ajrore të parakalojë deltaplanet ose parashutat me shpejtësi më të vogël ajrore në anën e djathtë.

11.4 Takimi i itinerareve të fluturimit të deltaplaneve me varje dhe të parashutave:

- a) Me takim të itinerarit të fluturimit kuptohet kur një itinerar i një deltaplani dhe i një parashute takohet me një itinerar të një deltaplani dhe të një parashute në një kënd nga 70 deri 160 gradë;
- b) Nëse ndodh takim i itinerareve të fluturimit të deltaplaneve me varje dhe të parashutave që fluturojnë afërsisht në të njëjtën lartësi, precedenca i takon atij që vjen nga e djathta kundrejt një veloreje me varje ose paraveloreje tjetër. Velorja me varje ose paravelorja që nuk e ka precedencën duhet të kthehet me qëllim që t'i japë mundësi asaj që ka precedencë.

11.5 Fluturimi në të njëjtën kolonë termale:

- a) Nëse disa deltaplane me varje dhe parashuta fluturojnë në të njëjtën kolonë termale, ajo që fillon rrotullimin e para ka precedencën;
- b) Deltaplanet dhe parashutat duhet të rrotullohen në të njëjtin drejtim (majtas ose djathtas).

11.6 Ulja:

- a) Nëse disa deltaplane me varje dhe parashuta ulen në një interval të shkurtër kohë në të njëjtin vend uljeje, precedencën e ka ajo që ka lartësinë më të ulët, përveç kur një deltaplan dhe parashuta tjetër është:

- në fazën e fundit të uljes; ose
- në rrezik.
- b) Në të gjitha situatat e tjera të fluturimit, zbatohen dispozitat e rregullave ajrore.

Neni 12 **Pajisjet e kërkuara**

Helmata. Gjatë fluturimit, personi që operon deltaplanet ose parashutat vendos një helm të përshtatshme për mbrojtje.

Parashuta e shpëtimit. Velorja me varje ose paravelorja nuk duhet të fluturojë më shumë se 10 metra mbi tokë nëse nuk ka parashutë shpëtimi për avionin ose pilotin.

Parashuta e shpëtimit paktohet të paktën një herë në vit ose më shpesh nëse kjo specifikohet nga prodhuesi. Ripaketimi kryhet nga një person i autorizuar nga prodhuesi ose një person i autorizuar për ripaketimin e parashutave të shpëtimit.

Ripaketimi konfirmohet duke futur datën në librin e shërbimit të parashutës dhe nënshkruhet nga personi që ka kryer ripaketimin.

Radiokomunikimi. Gjatë trajnimit të fluturimit, piloti student ruan komunikimin me radio me instruktorin e fluturimit.

Altimetri. Gjatë fluturimit në lartësi të mesme ose të larta, veçanërisht gjatë mbiflurimeve, personi që operon deltaplanet ose parashutat duhet të ketë një altimetër.

Neni 13 **Menaxheri i autorizuar/organizatori i aktivitetit të planifikuar**

13.1 Çdo aktivitet i organizuar me fluturim me deltaplan me varje dhe me parashuta mbikëqyret nga një menaxher i autorizuar/organizatori i aktivitetit të planifikuar.

Menaxheri i autorizuar/organizatori i aktivitetit të planifikuar duhet të jetë në moshë madhore dhe të ketë një licencë piloti të vlefshme për deltaplane me varje dhe me parashuta, ndërsa kur fluturon piloti student ai duhet të ketë një autorizim të vlefshëm të instruktorit të fluturimit.

13.2 Detyrat e menaxherit të autorizuar/organizatorit të aktivitetit të planifikuar janë si më poshtë:

- a) Verifikimi i kushteve të motit në vendin e shkëputjes, ose kur është e parashikueshme edhe te vendi i uljes;
- b) Bashkërendimi me një ofrues të shërbimeve të navigimit ajror;
- c) Marrja e vendimit për fillimin, ndërprerjen ose përfundimin e aktivitetit të fluturimit;
- d) Sigurimi i rregullit dhe disiplinës gjatë shkëputjes ose nëse është e parashikueshme edhe te vendi i uljes;
- e) Kontrolli i regjistrave të fluturimit për personat që synojnë të fluturojnë para fluturimit;
- f) Inspektimi vizual i deltaplaneve dhe i parashutave për saktësinë dhe pajisjet e përdorura, para fluturimit;
- g) Ndalimi i përdorimit të deltaplaneve me varje dhe të parashutave defekte;
- h) Ndalimi i fluturimit të personave, nëse vlerësohet që:
 - nuk është mendërisht ose fizikisht në gjendje për të fluturuar;
 - duket se është nën ndikimin e alkoolit, drogës ose substancave të tjera psikoaktive;
 - shkel rregullat e fluturimit ose rrezikon ndryshe sigurinë e fluturimit.

13.3 Detyrat e menaxherit të autorizuar/organizatorit të aktivitetit të planifikuar siç përmendet në paragrafin 2 të këtij neni zbatohen për instruktorët e fluturimit gjatë trajnimit praktik (fluturimit), me kusht që instruktori i fluturimit të jetë përgjegjës edhe për:

- a) kontrollin nëse studentët për licencën e pilotit për velore me varje ose paravelore janë të regjistruara në regjistrat e studentëve dhe pajisur me pajisjet e kërkuara;
- b) kaktimin e detyrave për pilotët studentë në kuadrin e programeve të aprovuara të trajnimit dhe mbikëqyrjen e fluturimeve të tyre me deltaplane me varje dhe me parashuta.



Neni 14 **Fluturimi aerobatik**

14.1 Fluturimi aerobatik lejohet vetëm nëse velorja me varje ose paravelorja është e destinuar për këtë fluturim ose në pajtim me udhëzimet e prodhuesit për një tip të caktuar të deltaplaneve me varje ose të parashutave.

14.2 Fluturimi aerobatik mbi fshatra, rrugë, hekurudha, kablllo, linja të energjisë elektrike, ndërtesa dhe grupe njerëzish është i ndaluar.

14.3 Fluturimet aerobatike kryhen mbi lartësinë minimale të sigurt.

Neni 15 **Trajnimi**

15.1 Kandidati kryhen trajnimin teorik dhe praktik (fluturimin) për përfitim të licencës së pilotit për deltaplane me varje dhe me parashuta ose autorizimin e përshtatshëm sipas një programi të aprovuar në një organizatë të aprovuar për trajnimin e pilotëve për deltaplane dhe parashuta.

Nëse kandidati ka përfunduar trajnimin teorik dhe praktik (fluturimin) në një organizatë trajnimi të aprovuar jashtë Republikës së Shqipërisë, Autoriteti përcakton nëse një program në të cilin është kryer trajnimi përmbush kërkesat e parashikuara në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

15.2 Programi kuadër për trajnimin teorik dhe praktik (fluturimin) për përfitim të licencës për pilot për deltaplanet dhe parashutat ose autorizimin e duhur është përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje. Bazuar në këtë program kuadër, çdo organizatë trajnimi zhvillon një program të hollësishëm trajnimi. Ky program trajnimi duhet të pranohet nga Autoriteti.

15.3 Para pranimit nga Autoriteti, një program i hollësishëm trajnimi duhet të vlerësohet nga një organizatë që zhvillon trajnim ose një person përgjegjës në ngarkim të trajnimit brenda një organizate, i cili përcakton dhe deklaron:

- a) Përputhshmërinë e programit të trajnimit me nevojat dhe aftësitë e organizatës së trajnimit;
- b) Përputhshmërinë e programit të trajnimit me këtë rregullore, program kuadër trajnimi dhe standardet e zbatueshme;
- c) Nevojën periodike për modifikimin ose ndryshimin e programit të trajnimit, të paktën një herë në vit për të përcaktuar efikasitetin, përshtatjen me nevojat dhe aftësitë e organizatës dhe përputhshmërinë me standardet e zbatueshme;
- d) Para trajnimit, një kandidat i mitur i paraqet organizatës së aprovuar për trajnim për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta një aprovim me shkrim të prindit ose kujdestarit.

Neni 16 **Pilotët studentë**

16.1 Para fluturimit të parë, piloti student duhet të ketë të paktën moshën 15 vjeç.

16.2 Nën mbikëqyrjen e një instruktori të autorizuar fluturimi, deltaplanet dhe parashutat mund të përdoren nga një pilot student, me kusht që ai të ketë kaluar trajnimin për përfitim të një licence për deltaplane me varje dhe parashuta, ose një kandidat që bën trajnimin për përfitim të autorizimit të përshtatshëm, të regjistruar në regjistrin e studentëve të pilotëve studentë në një organizatë të aprovuar trajnimi.

16.3 Njësitë e mësimdhënies dhe mbikëqyrja e trajnimit në vazhdim dokumentohen në regjistrin e përgjithshëm ose regjistrin e pilotëve studentë.

16.4 Një pilot student fluturon vetëm nëse ai ka një certifikatë të vlefshme mjekësore të lëshuar në pajtim me urdhrin e ministrit nr. 35, datë 23.3.2012 “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat për licencimin e ekuipazhit fluturues, organizatat e trajnimeve, seksionet aeromjekësore, AMC dhe AME”, si dhe parashikimet mbi kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit.

Neni 17
Eksperiencia e kërkuar

Një kandidat që përfton një licencë piloti për deltaplane me varje dhe parashuta ka të paktën 10 orë kohë totale fluturimi si pilot student në një deltaplan dhe në një parashutë, duke përfshirë të paktën:

- a) 60 fluturime të suksesshme, ku secila ka zgjatur më shumë se 5 minuta, nga të cilat më shumë se 30 fluturime mund të bëhen në një mënyrë të ndryshme shkëputjeje nga të cilat kandidati do të bëjë provimin, nëse organizata e aprovuar zhvillon trajnimin përfshin një mënyrë të ndryshme shkëputjeje;
- b) 3 fluturime nga të cilat secila është të paktën 2 orë.

Neni 18
Provimi për përfitim të licencës së pilotit për deltaplane dhe parashuta

18.1 Para marrjes së provimit për përfitim të licencës së pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta, kandidati duhet të jetë të paktën në moshën 16 vjeç.

18.2 Provimi për përfitim të një licence piloti për deltaplane me varje dhe parashuta përbëhet nga provimi teorik dhe praktik (fluturimi).

18.3 Në pajtim me privilegjet e përfuara nga zotëuesi i një licence piloti për deltaplane me varje dhe parashuta, kandidati duhet të demonstrojë një nivel njohurish teorike në lëndët e mëposhtme:

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit);
- b) Ndërtimi dhe materialet;
- c) Meteorologjia;
- d) Ligjet dhe rregulloret;
- e) Teknikat e fluturimit;
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e jashtëzakonshme;
- g) Dhënia e ndihmës së parë.

18.4 Verifikimi i njohurive teorike bëhet me shkrim. Pyetjet nga katalogu i pyetjeve zgjidhen nga ekzaminuesit.

Neni 19
Provimi teorik

19.1 Kandidati ndjek të gjithë pjesën teorike të provimit për marrjen e licencës së pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta ose autorizimet e përshtatshme, të organizuara dhe kryera nga Autoriteti.

19.2 Për ndjekjen e pjesës teorike të provimit, kandidati ka rekomandimin me shkrim të një organizate të aprovuar për trajnim për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta kur është bërë trajnimi, pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha elementeve të trajnimit teorik. Rekomandimi i lëshuar nga organizata e aprovuar për trajnim për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta është i vlefshëm për 12 muaj. Nëse gjatë kësaj periudhe kandidati nuk e merr provimin teorik, ai duhet të paraqesë prova për trajnim shtesë të zhvilluar nga organizata e aprovuar për trajnim për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta.

19.3 Kandidati ka kaluar me sukses pjesën teorike të provimit nëse ai merr të paktën 75% të numrit të krediteve që kërkohen për çdo lëndë. Kreditet jepen vetëm për përgjigjet e sakta.

19.4 Kandidati duhet të përsërisë të gjithë provimin teorik nëse pas përpjekjes së katërt nuk ka kaluar një lëndë, ose nëse periudha e 18 muajve kalendarikë ka skaduar qysh nga koha kur kërkuesi ka paraqitur kërkesën për provim. Para riparaqitjes së kërkesës për pjesën teorike të provimit, kandidati, në pajtim me rekomandimin e Autoritetit, kryen trajnim shtesë te një organizatë e aprovuar për trajnim për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta.

19.5 Kryerja e pjesës teorike është e vlefshme për periudhën e 24 muajve nga data e përfundimit të suksesshëm të të gjithë provimit teorik nga kandidati. Nëse kandidati nuk merr provimin praktik (fluturimin) gjatë kësaj periudhe, provimi teorik përsëritet i plotë.



Neni 20

Provimi praktik (fluturimi)

20.1 Para paraqitjes së kërkesës për provimin praktik (fluturimin) për marrjen e një licence për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta apo autorizimin e përshtatshëm, kërkuuesi duhet të ketë kaluar me sukses provimin teorik.

20.2 Për paraqitjen e kërkesës për provimin praktik (fluturimin), kandidati ka rekomandimin me shkrim të një organizate të aprovuar për trajnim fluturimi për deltaplane dhe parashuta ku është bërë trajnimi, pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha elementeve të nevojshme të trajnimit praktik (fluturimit).

20.3 Kandidati që përfton një licencë ose autorizim demonstroi me sukses nivelin e kompetencës si pilot për deltaplane me varje dhe parashuta, duke kryer procedurat dhe ushtrimet e përshtatshme në pajtim me privilegjet e licencës për pilot ose autorizimit të përshtatshëm për velore me varje ose paravelore.

20.4 I njëjti tip i deltaplanit ose parashutës ku kandidati ka marrë trajnimin, do të përdoret në provimin praktik (fluturimin).

20.5 Provimi praktik (fluturimi) ndahet në disa seksione që përfaqësojnë fazat e ndryshme të fluturimeve me deltaplane me varje dhe parashuta. Përmbajtja e provimit praktik (fluturimit), jepet në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje: Kandidati kalon me sukses të gjitha pjesët e një seksioni. Nëse kandidati nuk e kalon një seksion, ai/ajo mund ta ribëjë atë seksion. Konsiderohet si kalim i pasuksesshëm i provimit praktik (fluturimit) nëse kandidati nuk kalon më shumë se një seksion të provimit.

20.6 Konsiderohet si kalim i pasuksesshëm i provimit praktik (fluturimit) nëse kandidati nuk kalon një seksion, duke përfshirë seksionet që kanë kaluar me sukses në përpjekjet e mëparshme, gjatë rihënies së provimit.

20.7 Nëse kandidati, gjatë dy përpjekjeve të mëparshme nuk ka kaluar me sukses të gjitha seksionet e provimit praktik (fluturimit) ai dërgohet për trajnim praktik shtesë (fluturim), bazuar në rekomandimin me shkrim të provuesit.

Neni 21

Paraqitja e kërkesës, zgjerimi ose rinovimi i licencës ose aprovimit të përshtatshëm

21.1 Paraqitja e kërkesës për lëshimin e një licence piloti ose autorizimi i përshtatshëm për deltaplanet dhe parashutat, dhe zgjerimi apo rinovimi i vlefshmërisë së autorizimit i paraqitet Autoritetit në formën dhe mënyrën e parashikuar. Kërkesa shoqërohet me provat e përmbushjes së kushteve për pilotë dhe, ose autorizimin e përshtatshëm për deltaplane me varje dhe parashuta, ose për zgjerimin ose rinovimin e vlefshmërisë së autorizimit të përshtatshëm sipas parashikimit në këtë rregullore dhe rregullores përkatëse ku parashikohen kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit.

21.2 Çdo kufizim ose zgjerim i privilegjeve të dhëna me licencën ose autorizimin e përshtatshëm regjistrohet në licencë dhe certifikohet nga Autoriteti.

21.3 Autoriteti nuk lëshon, në të njëjtën kohë, më shumë se një licencë të vlefshme për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta për të njëjtin person.

21.4 Licenca e pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta lëshohet në formën e specifikuar në aneksin 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 22

Ushtrimi i privilegjeve

22.1 Privilegji i zotëruesit të një licence për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta është i pavarur nga kontrolli i velores me varje ose paravelores.

22.2 Ushtrimi i privilegjeve të dhëna zotëruesit të licencës së pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta mund t'u nënshtrohet kufizimeve ose autorizimeve dhe vlefshmërisë së certifikatës mjekësore.

22.3 Privilegjet e zotëruesit të licencës për pilot për deltaplane me varje dhe parashuta kufizohen në fluturimet për operacione jotregtare, deri sa të mbushen kushtet e mëposhtme:

- mosha madhore;
- eksperiencia e fluturimit prej të paktën 100 orë fluturimi dhe 100 shkëputje dhe ulje;
- verifikimi i aftësive të fluturimit nga një provues i autorizuar.

22.4 Pa shkelur kërkesat e paragrafit 3 të këtij neni, zotëruesi i licencës së pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta me vlerësim të instruktorit të fluturimit është që ai mund të marrë kompensim për:

a) trajnimin e kandidatëve për licencë piloti për deltaplane me varje dhe parashuta ose autorizimin e përshtatshëm;

b) vlerësimin e aftësive fluturoese të zotëruesit të licencës së pilotit ose autorizimit të përshtatshëm për deltaplane me varje dhe parashuta.

22.5 Privilegjet e zotëruesit të licencës së pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta janë të kufizuara vetëm në kushtet ditore VMC.

Neni 23

Detyrimi për të kryer dhe dhënë dokumentet për inspektim

23.1 Zotëruesi i licencës së pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta mban gjithmonë me vete licencën e vlefshme dhe certifikatën e vlefshme mjekësore gjatë ushtrimit të privilegjeve të dhëna nga licenca.

23.2 Pilotët ose pilotët studentë të deltaplaneve me varje ose paravelore mbajnë gjithmonë me vete dokumentin e identifikimit për identifikim të menjëhershëm.

23.3 Piloti ose piloti student për velore me varje ose paravelore paraqet pa vonesë për inspektim dokumentet sipas parashikimit në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni dhe regjistrin e fluturimeve të përfaqësuesi i autorizuar i Autoritetit kompetent.

Gjatë fluturimit vetëm, piloti student ka gjithmonë autorizimin me shkrim të instruktorit të fluturimit për kryerjen e fluturimit vetëm në deltaplane me varje dhe parashuta.

Neni 24

Regjistri i fluturimeve

24.1 Piloti ose piloti student për deltaplane me varje dhe parashuta regjistron të gjitha hollësitë e fluturimit në regjistrin e fluturimeve në formën dhe mënyrën e parashikuar në shtojcën 3 të kësaj rregulloreje.

24.2 Përgjegjësia për vërtetësinë e hyrjeve në regjistrin e fluturimit i takon pilotit ose pilotit student për deltaplane me varje dhe parashuta dhe instruktorit të fluturimit që certifikon hyrjet në regjistër.

Neni 25

Revokimi, pezullimi dhe kufizimet e licencave dhe autorizimeve

25.1 Autoriteti mund të revokojë, të pezullojë ose të kufizojë licencën e pilotit ose autorizimin e përshtatshëm për deltaplane me varje dhe parashuta të lëshuar në pajtim me këtë rregullore, nëse vërtetohet që piloti nuk përmbush kushtet e parashikuara në këtë rregullore, rregulloren përkatëse të miratuar nga Ministri i Transportit që parashikon kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit ose një rregullore tjetër që rregullon çështje të licencimit të pilotëve të deltaplaneve me varje dhe parashutave.

25.2 Nëse Autoriteti vendos të revokojë, pezullojë ose kufizojë një licencë piloti dhe/ose autorizimin e përshtatshëm për deltaplane dhe parashuta, piloti i deltaplanit ose parashutës ia kthen menjëherë licencën Autoritetit.



Neni 26

Zgjerimi i privilegjeve në metodën tjetër të shkëputjes

26.1 Privilegjet e dhëna nga licenca e pilotit për deltaplane me varje dhe parashuta kufizohen në metodën e shkëputjes që është zbatuar në provimin praktik (fluturimin). Ky kufizim pushon së qeni pasi piloti i deltaplanit ose parashutës të ketë përfunduar trajnimin shtesë në një organizatë të aprovuar për trajnim për deltaplane dhe parashuta në pajtim me programin kuadër sipas parashikimit në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

26.2 Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit për zgjerimin e privilegjeve, organizata e aprovuar për trajnimin e pilotit për deltaplane dhe parashuta lëshon një certifikatë për qëllimin e futjes në licencë të privilegjeve të zgjeruara.

Neni 27

Vazhdimësia e vlefshmërisë së licencave

27.1 Licencat e pilotëve për deltaplane me varje dhe parashuta lëshohen pa datë skadence.

27.2 Zotëruesi i licencës ka të drejtën për të përdorur privilegjet e dhëna nga licenca e pilotit për velore me varje përkatësisht paravelore, nëse gjatë 24 muajve të fundit ai ka përfunduar të paktën 8 orë kohë fluturimi dhe 15 shkëputje dhe ulje.

27.3 Nëse piloti i deltaplanit ose parashutës nuk përmbush kërkesat e specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, para marrjes së privilegjeve ai/ajo duhet të kalojë testin e aftësive (fluturimit) nën mbikëqyrjen e një provuesi fluturimi me velore me varje, përkatësisht paravelore.

Neni 28

Përftimi dhe zgjerimi i vlefshmërisë së vlerësimeve

28.1 Piloti për deltaplane me varje dhe parashuta mund të marrë vlerësimet e mëposhtme:

Vlerësimi "I": instruktur fluturimi për velore me varje/paravelore,

Vlerësimi "D": pilot i dytë për velore me varje/paravelore,

Vlerësim "T": pilot testimi për velore me varje/paravelore,

Vlerësimi "A": fluturim aerobatik për velore me varje/paravelore;

28.2 Periudha e vlefshmërisë për çdo vlerësim është 4 vjet.

28.3 Për zgjerimin e vlefshmërisë së vlerësimit kërkuesi duhet të paraqesë sa më poshtë:

a) prova për përfundimin e të paktën 40 orëve fluturim në velore me varje/paravelore gjatë periudhës së vlefshmërisë së vlerësimit, me kusht që çdo vit kalendarik ai/ajo të ketë përfunduar të paktën 10 orë kohë fluturimi;

b) një certifikatë që provon se ai/ajo ka marrë udhëzim për njohuri teorike nga një organizatë e aprovuar për trajnimin e pilotëve të veloreve me varje/paraveloreve;

c) certifikatë për gjendjen mjekësore.

28.4 Nëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së vlerësimit piloti nuk përmbush kërkesat e specifikuar, vlerësimi pushon së qeni i vlefshëm deri sa të përmbushen kërkesat.

Neni 29

Vlerësimi i instruktorit të fluturimit

29.1 Piloti i velores me varje, përkatësisht paravelore mund të kryejë trajnimin e pilotëve studentë vetëm nëse ai/ajo ka vlerësimin e duhur për instruktur fluturimi.

29.2 Para dhënies së provimit për marrjen e vlerësimit të instruktorit të fluturimit, kërkuesi duhet të jetë të paktën në moshën 18 vjeç dhe duhet të zotërojë një licencë piloti për velore me varje/paravelore për të paktën dy vjet, dhe duhet të ketë përfunduar të paktën 100 orë kohë fluturimi dhe

të ketë përfunduar të paktën dhjetë fluturime të ndryshme në velore me varje, përkatësisht paravelore nga të cilat dy fluturime duhet të jenë më të gjata se 50 km.

29.3 Gjatë trajnimit për përfitim e vlerësimit të instruktorit të fluturimit, kërkuesi duhet të kryejë trajnim teorik dhe praktik (fluturim) sipas programit të trajnimit në organizatën e aprovuar për trajnimin e pilotëve për deltaplane me varje dhe parashuta.

29.4 Pjesa teorike dhe praktike (fluturimi) e provimit për përfitim e vlerësimit të instruktorit të fluturimit për deltaplane me varje dhe parashuta përmban elementet e specifikuara në aneksin 3 të kësaj rregulloreje.

29.5 Privilegji i zotëruesit të licencës së pilotit të deltaplanit ose parashutës me një vlerësim instruktori fluturimi është i kufizuar në kushtet e trajnimit teorik dhe praktik (fluturimit) për përfitim e licencës së pilotit të velores me varje/paravelore nën mbikëqyrjen e një patronazhi në fluturim, deri sa zotëruesi të përfundojë sa më poshtë:

- a) të paktën tri leksione të pavarura;
- b) të asistojë të paktën 10 sesione trajnimi të veçanta me studentët.

Kufizimi hiqet nëse përbushen kërkesat e specifikuara, bazuar në rekomandimin e instruktorit të fluturimit që ka mbikëqyrur zotëruesin.

29.6 Privilegji i zotëruesit të vlerësimit të instruktorit të fluturimit është i kufizuar bazuar në mënyrën e shkëputjes dhe vlerësimet e renditura në licencën e pilotit të velores me varje/paravelore.

Neni 30

Vlerësimi i fluturimit aerobatik

30.1 Piloti i deltaplanit ose parashutës mund të zhvillojë fluturime aerobatike vetëm nëse ai/ajo ka vlerësimin përkatës.

30.2 Para dhënies së provimit për përfitim e vlerësimit të fluturimit aerobatik, kërkuesi duhet të jetë të paktën në moshën 18 vjeç dhe të zotërojë një licencë piloti për velore me varje/paravelore për të paktën dy vjet dhe ka përfunduar një kohë të përgjithshme prej të paktën 100 orë fluturim në deltaplan me varje, përkatësisht paravelore.

30.3 Gjatë trajnimit për përfitim e vlerësimit të fluturimit aerobatik, kërkuesi duhet të kryejë trajnim teorik dhe praktik (fluturim) sipas programit të trajnimit të aprovuar në organizatën e aprovuar për vlerësimin e pilotëve për deltaplane dhe parashuta.

30.4 Pjesa teorike dhe praktike (fluturimi) e provimit për përfitim e vlerësimit të fluturimit aerobatik për deltaplane me varje dhe parashuta përmban elementet e specifikuara në aneksin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 31

Vlerësimi i pilotit të dytë

31.1 Piloti i deltaplanit ose parashutës mund të zhvillojë fluturime si pilot i dytë vetëm nëse ai/ajo ka vlerësimin përkatës.

31.2 Para dhënies së provimit për përfitim e vlerësimit si pilot i dytë, kërkuesi duhet të jetë të paktën në moshën 18 vjeç dhe të zotërojë një licencë piloti për velore me varje/paravelore për të paktën dy vjet dhe ka përfunduar një kohë të përgjithshme prej të paktën 100 orë fluturim në velore me varje, përkatësisht paravelore, dhe ka përfunduar të paktën dhjetë fluturime të ndryshme në velore me varje, përkatësisht paravelore.

31.3 Gjatë trajnimit për përfitim e vlerësimit si pilot i dytë, kërkuesi duhet të kryejë trajnim teorik dhe praktik (fluturim) sipas programit të trajnimit të aprovuar në organizatën e aprovuar për trajnimin e pilotëve për deltaplane dhe parashuta.

31.4 Pjesa teorike dhe praktike (fluturimi) e provimit për përfitim e vlerësimit për pilot të dytë për deltaplane dhe parashuta përmban elementet e specifikuara në aneksin 3 të kësaj rregulloreje.

31.5 Nëse piloti zotëron vlerësimin e instruktorit të fluturimit ose vlerësimin e pilotit të testimit



për veloret me varje, përkatësisht paraveloret, pranohet pjesa teorike e tij/saj në provimin për vlerësimin e pilotëve për deltaplanet dhe parashutat.

Neni 32

Vlerësimi i pilotit të testimit

32.1 Piloti i deltaplanit ose parashutës mund të zhvillojë fluturime si pilot testimi vetëm nëse ai/ajo ka vlerësimin përkatës.

32.2 Para dhënies së provimit për përfitim e vlerësimit si pilot testimi, kërkuesi duhet të jetë të paktën në moshën 18 vjeç dhe të zotërojë një licencë piloti për deltaplane me varje dhe parashuta për të paktën dy vjet dhe ka përfunduar një kohë të përgjithshme prej të paktën 200 orë fluturim në deltaplane me varje, përkatësisht paravelore, nga të cilat 100 orë fluturim në deltaplane dhe në parashuta që janë të destinuara për gara, dhe ka përfunduar të paktën 20 orë fluturim në secilin prej tipave të ndryshëm në deltaplane me varje, përkatësisht paravelore.

32.3 Gjatë trajnimit për përfitim e vlerësimit të pilotit të testimit, kërkuesi duhet të kryejë trajnim teorik dhe praktik (fluturim) shtesë sipas programit të trajnimit të aprovuar në organizatën e aprovuar për trajnimin e pilotëve për deltaplane me varje dhe parashuta ose te prodhuesi i deltaplaneve dhe i parashutave ose në një qendër të specializuar për testimin e deltaplaneve me varje dhe të parashutave.

32.4 Pjesa teorike dhe praktike (fluturimi) e testimit për përfitim e vlerësimit për pilotë për deltaplane me varje dhe parashuta përmban elementet e specifikuar në aneksin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 33

Pranueshmëria e licencave të huaja

33.1 Me kërkesë të zotëruesit, Autoriteti mund të lëshojë një licencë shqiptare për pilotët e deltaplaneve me varje përkatësisht parashutave, mbi bazën e një licence piloti të vlefshme për parashuta të lëshuara në një shtet të huaj.

33.2 Para lëshimit të një licence shqiptare, zotëruesi i licencës së pilotit për velore me varje, përkatësisht paraveloreje të lëshuar në një shtet të huaj duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- të demonstrojë nivelin e njohurive teorike nga lënda e rregullave dhe rregulloreve;
- të paraqesë kontrollin e aftësisë së fluturimit të kryer nga një provues i autorizuar,
- të ketë një certifikatë të vlefshme për gjendjen mjekësore,

d) të ketë përfunduar të paktën 30 orë kohë të plotë fluturimi në një velore me varje, përkatësisht paravelore.

33.3 Me kërkesë të zotëruesit, Autoriteti mund të vlefësojë një licencë të huaj për pilotët e deltaplaneve me varje ose përkatësisht të parashutave ose një vlerësim përkatës. Periudha e vlefshmërisë së vlefësimit nuk duhet të jetë më e gjatë se një vit ose deri në skadimin e vlefshmërisë së licencës fillestare ose vlerësimit përkatës.

Neni 34

Licenca e përkohshme

34.1 Me kërkesë të aplikantit, Autoriteti mund të lëshojë një licencë të përkohshme për aplikantët të cilët kërkojnë njohje të licencave të huaja për pilot deltaplani apo parashute, me një afat kohor të nevojshëm për Autoritetin për të bërë vlerësimet përkatëse, por jo më të gjatë se 60 ditë.

34.2 Kërkesa për licencë të përkohshme duhet të diktohet nga nevoja urgjente për pjesëmarrje në një aktivitet të rëndësishëm.

34.3 Aplikanti gjithsesi duhet të dorëzojë pranë Autoritetit vërtetimet për plotësimin e kushteve të pikës 33.2.

Neni 35
Dispozita Ndëshkuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje mund të bëhen shkak për përgjegjësi penale në pajtim me Kodin Penal të RSH-së.

SHTOJCA 1
STRUKTURA E PROGRAMIT TRAJNUES

Struktura e programit trajnues përfshin orët e trajnimit teorik, dhe fluturimet e trajnimit praktik të specifikuar në strukturën e programit trajnues dhe është numri minimal i orëve që kërkohen për të përmbushur trajnimin e çdo kandidati.

A. STRUKTURA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT FLUTURUES PËR DELTAPLANET ME VARJE

1. Trajnimi për të përfutur licencë për deltaplanet me varje (SOLO)

Trajnimi zhvillohet në dy faza themelore, të bazuara në strukturën e programit të mëposhtëm:

Faza e parë-Pjesa teorike (20 orë)

a) Teori Fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	4 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	3 orë
c) Meteorologji	3 orë
d) Radiokomunikim	1 orë
e) Ligje dhe rregullore	2 orë
f) Teknikat e fluturimit	2 orë
g) Procedurat në situata të rrezikshme dhe emergjente	2 orë
h) Dhënia e ndihmës së shpejtë	2 orë
i) Testim	1 orë

Faza e parë-Pjesa praktike (10-20 trajnime)

a) Transportimi, ruajtja dhe përdorimi i deltaplanit me varje dhe i pajisjeve 1 orë

b) Montimi dhe çmontimi i deltaplanit me varje	1 orë
c) Kontrolli para fluturimit i deltaplanit me varje dhe sistemit të kavove	1 orë
d) Pozicioni i sigurisë gjatë rënies	1 orë
e) Komandimi i deltaplanit me varje në tokë	1 orë
f) Ushtrime në tokë të rrafshët	4 orë
g) Ushtrime në fushën e trajnimit-rrotullime pa u ngritur	1 orë
h) Ushtrime në vende kodrinore:	
- Ngritja një metër lartësi mbi tokë (praktikimi i ngritjeve dhe uljeve)	10 fluturime
- Ngritja 5 metra lartësi mbi tokë (praktikimi i ngritjeve dhe uljeve)	20 fluturime
i) Ushtrime në fushën e trajnimit:	
- Fluturime që arrijnë lartësinë 10 metra mbi tokë (praktikimi i uljeve dhe i ngritjeve)	20 fluturime
- Fluturime që arrijnë lartësinë 20 metra mbi tokë (praktikimi i uljeve dhe i ngritjeve)	10 fluturime
- Fluturime që arrijnë lartësinë 50 metra mbi tokë (praktikimi i uljeve dhe i ngritjeve)	10 fluturime

Në fazën e parë të trajnimit kandidati përfiton njohuri teorike të koncepteve bazë, parimeve dhe rregullave për përdorimin e deltaplaneve me varje. Pjesa teorike përfundon me një testim me shkrim, i cili përmban 50 ushtrime objektive, dhe niveli kalues është 75%.

Faza e dytë-Pjesa praktike (60 fluturime)

a) Fluturime në lartësi të mëdha-rreth, planerim, rreth për ulje	10 fluturime
b) Navigim në pjerrësi (nëse është e aplikueshme)	5 fluturime



c) Navigim në rrymat e ngrohta të ajrit (nëse është e aplikueshme)	10 fluturime
d) Përgatitje për testim	1 fluturim
2. Trajnim për të përfutuar licencë pilotimi për delta plane (ÇIFT)	
Trajnimi zhvillohet në dy faza kryesore dhe sipas programit të mëposhtëm:	
Faza e parë-Pjesa teorike (20 orë)	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	4 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	3 orë
c) Meteorologji	3 orë
d) Radiokomunikim	1 orë
e) Ligje dhe rregullore	2 orë
f) Teknikat e fluturimit	2 orë
g) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	2 orë
h) Dhënia e ndihmës së shpejtë	2 orë
i) Testim	1 orë
Faza e parë-Pjesa praktike (10-20 trajnime)	
a) Transportimi, ruajtja dhe përdorimi i deltaplaneve me varje dhe pajisjeve	1 orë
b) Montimi dhe çmontimi i deltaplaneve me varje	1 orë
c) Kontrolli para fluturimit dhe sistemi i kavove	1 orë
d) Pozicioni i sigurisë gjatë rënies	1 orë
e) Komandimi i deltaplanit me varje në tokë	1 orë
f) Ushtrime në tokë të rrafshët	4 orë
g) Fluturimi në çift-fluturim njohës	1 orë
h) Fluturimi në çift (ngritja, kthimi, rrethi, planerimi, rrethi për ulje)	20 fluturime
i) Ushtrime në fushën e trajnimit-pa u ngritur	1 orë
j) Ushtrime në terren kodrinor-ngritje dhe kërcim 1 metër lartësi mbi tokë (praktikimi i ngritjeve dhe uljeve)	5 fluturime
k) Ushtrime në fushën e trajnimit:	
- Fluturime që arrijnë lartësinë 10 metra mbi tokë (praktikimi i uljeve dhe ngritjeve)	5 fluturime
- Fluturime që arrijnë lartësinë 30 metra mbi tokë (praktikimi i uljeve dhe ngritjeve)	5 fluturime
- Fluturime që arrijnë lartësinë 50 metra mbi tokë (praktikimi i uljeve dhe ngritjeve)	5 fluturime
Në fazën e parë të trajnimit kandidati përfiton njohuri teorike të koncepteve bazë, parimeve dhe rregullave për përdorimin e deltaplaneve me varje. Pjesa teorike përfundon me një testim me shkrim, i cili përmban 50 ushtrime objektive, dhe niveli kalues është 75%.	
Faza e dytë-Pjesa praktike (60 fluturime)	
a) Fluturime në lartësi të mëdha-rreth, planerim, rreth për ulje)	10 fluturime
b) Navigim në pjerrësi (nëse është e aplikueshme)	5 fluturime
c) Navigim në rrymat e ngrohta të ajrit (nëse është e aplikueshme)	10 fluturime
d) Përgatitje për testim	1 fluturim
3. Trajnim për të përfutuar privilegjin e instruktorit të fluturimit për deltaplanet me varje	
Trajnimi për nxjerrjen e një instruktore fluturimi kërkon prezencë të plotë në pjesën teorike dhe praktike, si dhe praktikim në një organizatë trajnimit të aprovuar nën mbikëqyrjen e një instruktore të certifikuar fluturimi.	
Pjesa teorike (25 orë)	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	3 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	2 orë
c) Meteorologji	3 orë
d) Radiokomunikim	1 orë

e) Ligje dhe rregullore	3 orë
f) Teknikat e fluturimit	2 orë
g) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	3 orë
h) Metodatat e mësimdhënies dhe psikologji	4 orë
i) Dhënia e ndihmës së shpejtë	4 orë
Pjesa praktike	
a) Trajnimi në tokë: aftësitë kontrolluese, metodat e mësimdhënies	4 orë
b) Trajnimi në lartësi të vogla dhe të mesme: aftësitë kontrolluese, metodat e mësimdhënies	10 orë
c) Trajnimi në lartësi të mëdha: aftësitë kontrolluese, metodat e mësimdhënies	5 orë
d) Trajnimi për fluturime çift	
Pjesa teorike (16 orë) jo e detyrueshme për kandidatët që e kanë një privilegj të vlefshëm instruktori	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	2 orë
b) Meteorologji	3 orë
c) Radiokomunikim	1 orë
d) Ligje dhe rregullore	3 orë
e) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	3 orë
f) Dhënia e ndihmës së shpejtë	4 orë
Pjesa praktike	
Të paktën 10 fluturime në çift me deltaplane me varje në lartësi të mëdha nën mbikëqyrjen e instruktorit të fluturimit dhe pasagjer i cili ka licencë fluturimi minimale për deltaplane me varje.	
5. Trajnimi për lëshimin e një privilegji të pilotit të kontrollit	
Pjesa teorike (20 orë)	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	2 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	2 orë
c) Meteorologji	3 orë
d) Radiokomunikim	1 orë
e) Metodatat e mësimdhënies dhe psikologji	5 orë
f) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	5 orë
Pjesa praktike	
Fluturime me të paktën 5 deltaplane me varje të ndryshme	20 orë
6. Trajnimi për lëshimin e privilegjeve për fluturimet akrobatike	
Pjesa teorike (18 orë)	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	2 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	2 orë
c) Ligje dhe rregullore	2 orë
d) Teknikat e fluturimit	4 orë
e) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	4 orë
f) Dhënia e ndihmës së shpejtë	4 orë
Pjesa praktike	
a) Trajnimi në tokë: parimet e manovrave akrobatike	4 orë
b) Procedurat e emergjencave gjatë fluturimeve akrobatike	10 fluturime
c) Manovrat akrobatike	20 fluturime
7. Trajnimi për rritjen e privilegjeve për ngritje nga kodrat	
Pjesa teorike (10 orë)	
a) Mënyrat e ngritjes nga kodrat	2 orë
b) Teknikat e fluturimit në pjerrësi	2 orë
c) Situatat e rrezikshme	2 orë
d) Ligje dhe rregullore	2 orë
e) Fushat e ngritjes dhe të uljes	2 orë



Pjesa praktike	
a) Përgatitje në tokë	2 orë
b) Fluturime në të paktën 3 fusha të ndryshme	10 fluturime
c) Organizimi i fluturimeve në aeroporte	10 fluturime
8. Trajnimi për rritjen e privilegjeve për ngritje me tërheqje (vinç stacionar ose me një mjet lëvizës me vinç ose me varkë ose me mjet lëvizës/varkë duke përdorur një kavo statike.	
Pjesa teorike (12 orë)	
a) Pajisjet (vinçat, litarët tërheqës, elementet e dobëta, lidhja me radio, pajisja e shkëputjes, karroca e ngritjes)	2 orë
b) Teori fluturimi (parimet fizike gjatë tërheqjes)	2 orë
c) Teknikat e fluturimit gjatë tërheqjes (“Nisja e sigurt”, teknikat e ngritjes, shkëputja)	2 orë
d) Situata të rrezikshme	2 orë
e) Ligje dhe rregullore	2 orë
f) Aerodromet	2 orë
Pjesa praktike	
a) Përgatitje në tokë	2 orë
b) Fluturime deri në 300 metra të shkëputura	10 fluturime
c) Organizimi i fluturimit me tërheqje	10 fluturime
9. Trajnimi për rritjen e privilegjeve për ngritje me vinç	
Pjesa teorike	
a) Pajisjet (vinçat, litarët tërheqës, elementet e dobëta, lidhja me radio, pajisja e shkëputjes, karroca e ngritjes)	2 orë
b) Teori fluturimi (parimet fizike gjatë përdorimit të vinçit)	2 orë
c) Teknikat e fluturimit gjatë përdorimit të vinçit (teknikat e ngritjes, shkëputja)	2 orë
d) Situata të rrezikshme	2 orë
e) Ligje dhe rregullore	2 orë
f) Aeroportet	2 orë
Pjesa praktike	
a) Përgatitje në tokë	2 orë
b) Fluturime deri në 300 metra të shkëputura	10 fluturime
c) Organizimi i fluturimit me përdorimin e vinçit	10 fluturime
10. Trajnimi për rritjen e privilegjeve për ngritje me motor	
Pjesa teorike (12 orë)	
a) Teori fluturimi (parimet fizike për ngritjen dhe fluturimin me motor)	2 orë
b) Projektet dhe konstruksioni i deltaplaneve me varje me motor	2 orë
c) Teknikat e fluturimit me motor	2 orë
d) Situata të rrezikshme	2 orë
e) Ligje dhe rregullore	2 orë
f) Aerodromet	2 orë
Pjesa praktike	
a) Përgatitje në tokë (prova dhe ngrohja e motorit)	1 orë
b) Fluturim deri në lartësinë 30 metra	5 fluturime
c) Fluturim deri në lartësinë 300 metra	5 fluturime
d) Organizimi i fluturimit në ngritje me motor	10 fluturime
11. Seminare për rifreskimin e njohurive me qëllim rritjen e privilegjeve	
Rritja e privilegjeve, midis të tjerash (fluturime të vazhdueshme, dhe ruajtja e gjendjes mjekësore), me këtë rregullore do të thotë përditësimi i vazhdueshëm i njohurive. Rifreskimi i njohurive bëhet nëpërmjet seminareve profesionale të organizuara nga organizatat trajnuese të aprovuara. Seminarat përfshijnë pjesën teorike, ndërsa pjesa praktike është fakultative, por është e mundur.	

Përbajtja e kursit përcaktohet në përputhje me problematikat dhe nevojat.

Pas seminarit, organizata e aprovuar për trajnimin jep certifikata për pjesëmarrjen në seminar, e cila shërben si një provë për kursin e rifreskimit të dijeve me qëllim rritjen e privilegjeve.

B. PROGRAMI I TRAJNIMIT TË FLUTURIMIT ME PARASHUTË

1. Trajnimi për të marrë licencë fluturimi për parashutë

Trajnimi zhvillohet në dy faza dhe bazohet në programin e mëposhtëm:

a) Prezantim	1 orë
b) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	2 orë
c) Konstruksioni dhe materialet	2 orë
d) Meteorologji	3 orë
e) Radiokomunikim	1 orë
f) Ligje dhe rregullore	2 orë
g) Teknikat e fluturimit	2 orë
h) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	3 orë
i) Dhënia e ndihmës së shpejtë	4 orë
Faza e parë-Pjesa teorike (10-20 trajnime)	
a) Njohuri dhe përdorimi i pajisjes, përgatitja për fluturim	1 orë
b) Ngritja e kupolës	3 orë
c) Përdorimi i parashutës në tokë	3 orë
d) Faza e ngritjes dhe shkëputja nga toka	3 orë
e) Fluturime në lartësi të vogla deri në 10 metra: praktikimi i ngritjes dhe uljes	10-15 fluturime
f) Fluturime në lartësi të vogla deri në 30 metra: praktikimi i ngritjes dhe uljes	10-15 fluturime
g) Fluturime në lartësi të vogla deri në 50 metra: kthesa të lehta, kthesa 180 gradë, planerimi për 20-30 fluturime	20-30 fluturime
h) Fluturime në lartësi të mesme; kthesa, rrrathë, planerim për ulje	10 fluturime
i) Hedhje mbrapsht: teknika e kombinuar me komandimet dhe teknikat e litarëve A dhe D	3 orë
j) Fluturim kontrolli në lartësi mesatare- ulje brenda rrethit të uljes	1-5 fluturime
k) Fluturim çift me një instruktor fluturimi	1-2 fluturime
Në fazën e parë të trajnimit kandidati përfiton njohuri teorike të koncepteve bazë, parimeve dhe rregullave për përdorimin e parashutave. Pjesa teorike përfundon me një testim me shkrim, i cili përmban 50 ushtrime objektive dhe niveli kalues është 75%.	
Faza e dytë-Pjesa teorike (20 orë)	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	2 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	2 orë
c) Meteorologji	3 orë
d) Radiokomunikim	1 ore
e) Ligje dhe rregullore	2 orë
f) Teknikat e fluturimit	3 orë
g) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	4orë
h) Dhënia e ndihmës së shpejtë	2 orë
i) Testim	1 orë
Faza e dytë-Pjesa praktike(60 fluturime)	
a) Nisja mbrapsht	3 orë
b) Fluturim në lartësi mesatare; rregullimi i lartësisë, rrrathë, planerim, rreth për ulje	5 fluturime
c) Fluturime në lartësi të mëdha; navigimi në lidhje me erën, terrenin dhe avionët e tjerë në ajër, kthesat, “figura 8-she” dhe rrotullimi (kthesa 3600)	5-10 fluturime



d) Navigimi në pjerrësi (nëse aplikohet)	5-10 fluturime
e) Komandimi nëpërmjet lëvizjes së peshës dhe me Litarët D	2-3 fluturime
f) Mbyllja laterale: simetrike dhe e njëanshme	3-5 fluturime
g) Navigimi në rryma të ngrohta mesatare (nëse aplikohet)	10-15 fluturime
h) Humbje e menjëhershme e lartësisë me manovrën “B-stall” dhe spirale e butë	5 fluturime
i) Navigimi në rryma të ngrohta të larta (nëse aplikohet)	10-15 fluturime
j) Spirale e ashpër	2-3 fluturime
k) Mbikalim	10-15 fluturime
l) Përgatitje për testim	2-3 fluturime
Në pjesën teorike të fazës së dytë kandidati për pilot plotëson njohuritë e fazës së parë, ndërsa pjesa e trajnimit praktik përfshin fluturime në lartësi të mëdha. Testimi i njohurive përmban 50 detyra objektive dhe niveli kalues është 75%.	
2. Trajnimi për marrjen e privilegjeve si instruktor fluturimi për parashutë	
Trajnimi për marrjen e privilegjeve si instruktor fluturimi për parashutë parashikon prezencë të plotë në pjesën teorike dhe praktike dhe praktikum në organizatë trajnuese nën mbikëqyrjen e një instruktori të certifikuar fluturimi.	
Pjesa teorike (25 orë)	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	3 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	2 orë
c) Meteorologji	3 orë
d) Radiokomunikim	1 orë
e) Ligje dhe rregullore	3 orë
f) Teknikat e fluturimit	2 orë
g) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	3 orë
h) Metodat e mësimdhënies dhe psikologji	4 orë
i) Dhënia e ndihmës së shpejtë	2 orë
Pjesa praktike	
a) Fusha e trajnimit; aftësitë kontrolluese, metodologjia e mësimdhënies, menaxhimi në tokë,	4 orë
b) Trajnimi në lartësi të vogla dhe të mesme: aftësitë kontrolluese, metodat e mësimdhënies	10 fluturime
c) Trajnimi në lartësi të mëdha: aftësitë kontrolluese, metodat e mësimdhënies	5 fluturime
d) Procedurat e emergjencës	2-3 fluturime
3. Trajnimi për të përfituar privilegjet e fluturimit në çift	
Pjesa teorike (20 orë) jo e detyrueshme për kandidatët të cilët e kanë një privilegj të vlefshëm instruktori	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	2 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	2 orë
c) Meteorologji	4 orë
d) Radiokomunikim	1 orë
e) Ligje dhe rregullore	3 orë
f) Teknikat e fluturimit	2 orë
g) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	3 orë
h) Dhënia e ndihmës së shpejtë	4 orë
Pjesa praktike	
a) Stërvitje në tokë; aftësitë kontrolluese	2 orë
b) Fluturim me parashutë në çift në lartësi mesatare dhe të mëdha nën mbikëqyrjen e një instruktori dhe pasagjeri të ketë të paktën licencë pilotimi parashutetë paktën	10 fluturime
c) Procedurat e emergjencës	2-3 fluturime

4. Trajnimi për t'u autorizuar si pilot kontrolli (testimi)	
Pjesa teorike (20 orë)	
a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) nivele më të larta	5 orë
b) Struktura dhe materiale	5 orë
c) Kriteret për metodat e kontrollit	5 orë
d) Situatat e rrezikshme dhe të jashtëzakonshme	5 orë
Pjesa praktike	
a) Fluturime me të paktën 5 lloje parashutash të ndryshme	20 orë
b) Procedurat e emergjencës-trajnim	minimumi 5 fluturime
5. Trajnimi për përfitimin e autorizimit për fluturime akrobatike	
Pjesa teorike (20 orë)	
a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	2 orë
b) Konstruksioni dhe materialet	2 orë
c) Meteorologji	2 orë
d) Ligje dhe rregullore	2 orë
e) Teknikat e fluturimit	4 orë
f) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave	4 orë
g) Dhënia e ndihmës së shpejtë	4 orë
Pjesa praktike	
a) Përgatitje në tokë; parimet e manovrave akrobatike	4 orë
b) Procedurat e emergjencës	minimumi 10 fluturime
c) Manovrat akrobatike	minimumi 20 fluturime
6. Trajnimi për rritjen e aftësive për ngritje nga kodrat	
Pjesa teorike (10 orë)	
a) Metodot për ngritjen nga kodrat	2 orë
b) Teknika e fluturimit në pjerrësi	2 orë
c) Situata të rrezikshme	2 orë
d) Ligje dhe rregullore	2 orë
e) Ngritja dhe vendet e uljes	2 orë
Pjesa praktike	
a) Përgatitje në tokë	2 orë
b) Fluturime në të paktën 3 fusha të ndryshme	10 fluturime
c) Organizimi i fluturimeve në aeroport	10 fluturime
7. Trajnimi për rritjen e privilegjeve për ngritje me tërheqje (vinç stacionar ose me një mjet lëvizës me vinç ose me varkë ose me mjet lëvizës/varkë duke përdorur një kavo statike.	
Pjesa teorike	
a) Pajisjet (vinçat, litarët tërheqës, elementet e dobëta, lidhja me radio, pajisja e shkëputjes, karroca e ngritjes)	2 orë
b) Teori fluturimi (parimet fizike gjatë tërheqjes)	2 orë
c) Teknikat e fluturimit gjatë tërheqjes("Nisja e sigurt", teknikat e ngritjes, shkëputja)	2 orë
d) Situata të rrezikshme	2 orë
e) Ligje dhe rregullore	2 orë
f) Aerodromet	2 orë
Pjesa praktike	
a) Përgatitje në tokë	2 orë
b) Fluturime deri në 300 metra të shkëputura	10 fluturime
c) Organizimi i fluturimit me tërheqje	10 fluturime
8. Trajnime për rritjen e aftësive për ngritjen me përdorimin e motorëve	
Pjesa teorike (12 orë)	



- a) Teoria e fluturimit (parimet fizike gjatë uljes dhe fluturimit me përdorimin e motorëve) 2 orë
- b) Projektimi dhe konstruksioni i parashutave me motorë ndihmës 2 orë
- c) Teknikat e fluturimit me përdorimin e motorëve 2 orë
- d) Situata të rrezikshme 2 orë
- e) Ligje dhe rregullore 2 orë
- f) Aerodromet 2 orë
- Pjesa praktike
- a) Përgatitje në tokë (prova dhe ngrohja e motorit) 1 orë
- b) Fluturime deri në lartësi 30 metra 5 fluturime
- c) Fluturime deri në lartësi 300 metra 5 fluturime
- d) Organizimi i fluturimit me përdorimin e motorëve në ngritje 10 fluturime

9. Seminare për rifreskimin e njohurive me qëllim rritjen e autorizimeve

Rritja e autorizimeve, midis të tjerash (ngritje të vazhdueshme, dhe gjendje të mirë shëndetësore) nën këtë rregullore, do të thotë rifreskimi i njohurive. Ky bëhet nëpërmjet seminareve profesionale të organizuara nga organizata trajnimi të aprovuara. Seminarët përfshijnë një pjesë teorike, ndërsa pjesa praktike është fakultative, por e mundshme.

Përmbajtja e kursit përcaktohet në përputhje me problematikat dhe nevojat.

Pas seminarit, organizata e aprovuar për trajnimin jep certifikata për pjesëmarrjen në seminar, e cila shërben si një provë për kursin e rifreskimit të dijeve me qëllim rritjen e autorizimeve.

SHTOJCA 2

PROGRAME PËR ZHVILLIMIN E TESTIMEVE PËR MARRJEN E LICENCAVE TË PILOTIMIT DHE TËAUTORIZIMEVE PËR DELTAPLANET ME VARJE DHE PARASHUTAT

TESTIMET PËR PILOTËT E DELTAPLANEVE ME VARJE

Testime për marrjen e licencave të pilotimit për deltaplanet me varje

Pjesa teorike

- a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) 5 pyetje
- b) Konstruksioni dhe materialet 5 pyetje
- c) Meteorologji 10 pyetje
- d) Radiokomunikim 5 pyetje
- e) Ligje dhe rregullore 5 pyetje
- f) Teknikat e fluturimit 10 pyetje
- g) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave 10 pyetje
- h) Dhënia e ndihmës së shpejtë 5 pyetje

Pjesa praktike

Seksioni 1: Përgatitja dhe ngritja

- a) Kontrolli para fluturimit i deltaplaneve me varje, dokumentacioni dhe përgatitja;
- b) Njohuri mbi metodat e përdorimit të deltaplanit me varje;
- c) Kontrolllet para ngritjes.

Seksioni 2: Metoda e ngritjes (performohet një nga 4 mënyrat e mundshme për ngritje)

Seksioni 2A: Ngritja nga kodra

- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes;
- b) Profili i duhur i fluturimit;
- c) Simulim i një ngritjeje të pasuksesshme;

Seksioni 2B: Ngritja me tërheqje nga një vinç stacionar ose me përdorimin e vinçit në një mjet lëvizës apo varkë, ose me një kavo statike nga një mjet/varkë.

d) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes, përfshirë sinjalet për përdoruesin e vinçit (të makinës apo varkës);

- e) Profili i duhur i fluturimit;
- f) Simulim i shkëputjes së kavos tërheqëse;
- g) Dijeni e pozicionit;
- h) Shkëputja.

Seksioni 2C: Ngritje me tërheqje me avion

- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes, përfshirë komunikimin me pilotin e avionit tërheqës;
- b) Rulimi, ngritja dhe marrja e lartësisë;
- c) Përfundimi i rulimit (simulim ose provim me gojë);
- d) Ndjekja e avionit tërheqës kur fluturon në vijë të drejtë dhe në kthesa;
- e) Korrigjimi i pozicionit të pasaktë gjatë ndjekjes;
- f) Shkëputja.

Seksioni 2D: Ngritja me përdorimin e motorit ndihmës

- a) Procedurat për ngritje në aeroport;
- b) Rulimi, ngritja dhe marrja e lartësisë;
- c) Monitorimi i fluturimit dhe aftësitë e fluturimit gjatë fazës së ngritjes;
- d) Simulimi i fikjes së motorit gjatë ngritjes;
- e) Fikja e motorit.

Seksioni 3: Veprime të përgjithshme

- a) Ruajtja e pozicionit dhe shpejtësisë në fluturim horizontal;
- b) Koordinimi gjatë kthesave me kënd 300, procedurat dhe metodat e vëzhgimit dhe shmangia e përplasjeve;
- c) Marrja e drejtimit pas kthesave drejt pikës së referimit;
- d) Fluturim me kënde të larta ndeshjeje (me shpejtësi të ulët);
- e) Fluturim COATED dhe dalja nga ky fluturim;
- f) Kthesë e koordinuar me një kënd 450, procedurat dhe metodat e vëzhgimit dhe shmangia e përplasjeve.

Seksioni 4: Rrethi për ulje, afrimi dhe ulja (ndalohet t'i jepen kandidatit instruksione me radio, veç në rast emergjence)

- a) Procedurat për afrimin, rrethi për ulje (drejtimi për futjen në rreth uljeje mund të jetë i paracaktuar);
- b) Procedurat e monitorimit dhe shmangia e përplasjeve;
- c) Kontrollat para uljes;
- d) Fluturimi në rreth për ulje, afrim dhe ulja;
- e) Precizioni i uljes (ulje në zonën e përcaktuar 100x50 m).

Kur ngrihet nga një kodër, ekzaminuesi kontrollon kandidatin në vendin e ngritjes dhe një tjetër ekzaminues ndodhet në vendin e uljes.

2. Testime për marrjen e autorizimit si instruktor fluturimi

Pjesa teorike

- | | |
|---|-----------|
| a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) | 15 pyetje |
| b) Konstruksioni dhe materialet | 5 pyetje |
| c) Meteorologji | 10 pyetje |
| d) Ligje dhe rregullore | 5 pyetje |
| e) Teknikat e fluturimit | 10 pyetje |
| f) Dhënia e ndihmës së shpejtë | 5 pyetje |
| g) Metodot e mësimdhënies | 10 pyetje |

Pjesa praktike

- a) Demonstrimi i ushtrimeve në tokë dhe i fazës së ngritjes dhe të drejtimit (fluturimit, komandimit) i deltaplanit;
- b) Me varje. Drejtimi i rrethit të kthimit për ulje mund të përcaktohet më parë;
- c) Fluturim ekzaminimi me precizion dhe saktësi për ulje në zonën e përcaktuar; 100 x 50 për rreth në ulje.



3. Ekzaminimet për të marrë autorizim për fluturim në çift
- Pjesa teorike
- a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) 10 probleme
 - b) Meteorologji 10 pyetje
 - c) Ligje dhe rregullore 10 pyetje
 - d) Procedurat në situata të rrezikshme dhe të jashtëzakonshme 10 pyetje
 - e) Dhënia e ndihmës së shpejtë 5 pyetje
- Pjesa praktike
- a) Demonstrimi i ushtrimeve në tokë dhe i fazës së ngritjes dhe drejtimit (fluturimit, komandimit) i deltaplanit me varje. Drejtimi i rrethit të kthimit për ulje mund të përcaktohet më parë.
 - b) Fluturim ekzaminimi me precizion dhe saktësi për ulje në zonën e përcaktuar; 100 x 50 për rreth në ulje.
4. Ekzaminime për të marrë autorizimin për pilot kontrolli
- a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) 10 probleme
 - b) Struktura dhe materiale 10 pyetje
 - c) Kriteret e metodës së kontrollit 10 pyetje
 - d) Procedurat në situata të rrezikshme dhe të jashtëzakonshme 10 pyetje
- Pjesa praktike
- Një fluturim në dy modele të ndryshme deltaplanesh me varje (të fillohet mbi sipërfaqe ujore)
5. Ekzaminime për të marrë autorizim për fluturime akrobatike
- Pjesa teorike
- a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) 10 probleme
 - b) Struktura dhe materiale 5 pyetje
 - c) Ligje dhe rregullore 5 pyetje
 - d) Teknika e fluturimit 10 pyetje
 - e) Procedurat në situata të rrezikshme dhe të jashtëzakonshme 10 pyetje
 - f) Dhënia e ndihmës së shpejtë 5 pyetje
- Pjesa praktike
- Performimi i fluturimeve të kërkuara për të treguar manovrat akrobatike.
- B. TESTIME PËR PILOT PARASHUTASH**
1. Testime për të marrë një licencë për pilotim parashute
- a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) 20 pyetje
 - b) Konstruksioni dhe materialet 5 pyetje
 - c) Meteorologji 10 pyetje
 - d) Radiokomunikim 5 pyetje
 - e) Ligje dhe rregullore 5 pyetje
 - f) Teknikat e fluturimit 10 pyetje
 - g) Procedurat e situatave të rrezikshme dhe të emergjencave 10 pyetje
 - h) Dhënia e ndihmës së shpejtë 5 pyetje
- Pjesa praktike
- Seksioni 1: Përgatitja dhe ngritja
- a) Kontrolli para fluturimit i parashutës, dokumentacioni dhe përgatitja;
 - b) Njohuri mbi metodat e përdorimit të parashutës;
 - c) Kontrolllet para ngritjes.
- Seksioni 2: Metoda e ngritjes (performohet një nga 3 mënyrat e mundshme për ngritje)
- Seksioni 2A: Ngritja nga kodra
- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes;
 - b) Profili i duhur i fluturimit;
 - c) Simulim i një ngritjeje të pasuksesshme.

Seksioni 2B: Ngritja me tërheqje nga një vinç stacionar ose me përdorimin e vinçit në një mjet lëvizës apo varkë, ose me një kavo statike nga një mjet/varkë.

- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes, përfshirë sinjalet për përdoruesin e makinës apo varkës;
- b) Profili i duhur i fluturimit;
- c) Simulim i shkëputjes së kavos tërheqëse;
- d) Dijeni e pozicionit;
- e) Shkëputja.

Seksioni 2C: Ngritja me përdorimin e motorit ndihmës:

- a) Procedurat për ngritje në aeroport;
- b) Rulimi, ngritja dhe marrja e lartësisë;
- c) Monitorimi i fluturimit dhe aftësitë e fluturimit gjatë fazës së ngritjes;
- d) Simulimi i fikjes së motorit gjatë ngritjes;
- e) Fikja e motorit.

Seksioni 3: Veprime të përgjithshme

- a) Ruajtja e pozicionit dhe shpejtësisë në fluturim horizontal;
- b) Marrja e drejtimit pas kthesave drejt pikës së referimit;
- c) Manovër për humbje të menjëhershme lartësie (nëse aplikohet).

Seksioni 4: Rrethi për ulje, afrimi dhe ulja (ndalohe t'i jepen kandidatit instruksione me radio, veç në rast emergjence).

a) Procedurat për afrimin, rrethi për ulje (drejtimi për futjen në rreth uljeje mund të jetë i paracaktuar);

- b) Procedurat e monitorimit dhe shmangia e përplasjeve;
- c) Kontrollat para uljes;
- d) Fluturimi në rreth për ulje, afrimi dhe ulja;
- e) Precizioni i uljes (ulje në zonën e përcaktuar 100x50 m).

2. Testime për marrjen e autorizimit si instruktor fluturimi

Pjesa teorike

- | | |
|---|-----------|
| a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) | 15 pyetje |
| b) Konstruksioni dhe materialet | 5 pyetje |
| c) Meteorologji | 10 pyetje |
| d) Ligje dhe rregullore | 5 pyetje |
| e) Teknikat e fluturimit | 10 pyetje |
| f) Procedurat në situata të rrezikshme dhe të jashtëzakonshme | 10 pyetje |
| g) Dhënia e ndihmës së shpejtë | 5 pyetje |
| h) Metodatat e mësimdhënies | 10 pyetje |

Pjesa praktike

a) Demonstrimi i ushtrimeve në tokë dhe i fazës së ngritjes dhe të drejtimit (fluturimit, komandimit) të parashutës, kontrolli i ngritjes së pasuksesshme, përdorimi në tokë;

b) Fluturim ekzaminues në performimin e manovrave për humbje të menjëhershme të lartësisë të paktën 10 metra, precizion dhe saktësi në ulje në zonën e përcaktuar 50x50 metra për rreth uljeje;

c) Procedurat e emergjencave (të përformuara si pjesë e detyruar gjatë trajnimit, kështu që kjo pjesë mund të anashkalohe).

3. Ekzaminimet për të marë autorizim për fluturim në çift

Pjesa teorike

- | | |
|---|-----------|
| a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) | 10 pyetje |
| b) Meteorologji | 10 pyetje |
| c) Ligje dhe rregullore | 10 pyetje |
| d) Procedurat në situata të rrezikshme dhe të jashtëzakonshme | 10 pyetje |
| e) Dhënia e ndihmës së shpejtë | 5 pyetje |



Pjesa praktike

a) Fluturim testimi në kontrollin e ngritjes së pasuksesshme të parashutës në çift në fazën e kupolave të ngritura;

b) Ngritje e saktë e parashutës në çift, me një pasagjer që të paktën ka një licencë pilotimi parashute;

c) Ulje me precizion dhe saktësi në zonën e përcaktuar 50x50 metra për rreth uljeje.

4. Ekzaminime për të marrë autorizimin për pilot kontrolli

a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) 10 pyetje

b) Struktura dhe materiale 10 pyetje

c) Kriteret e metodës së kontrollit 10 pyetje

d) Procedurat në situata të rrezikshme dhe të jashtëzakonshme 10 pyetje

Pjesa praktike

Një fluturim në dy modele të ndryshme parashutash ku të performohen procedurat e emergjencave, si një palosje e pavullnetshme mbi 50%, kthesë negative, humbje lartësie në spiral mbi 15 m/sek. (të performohen mbi sipërfaqe ujore)

5. Ekzaminime për të marrë autorizim për fluturime akrobatike

Pjesa teorike

a) Teori fluturimi (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) 10 pyetje

b) Struktura dhe materiale 5 pyetje

c) Ligje dhe rregullore 5 pyetje

d) Teknika e fluturimit 10 pyetje

e) Procedurat në situata të rrezikshme dhe të jashtëzakonshme 10 pyetje

f) Dhënia e ndihmës së shpejtë 5 pyetje

Pjesa praktike

Manovra akrobatik, spirale asimetrike, palosje e krahut, satelit, kthesa negative, “shtoper i plotë”, laku. Performimi i numrit të kërkuar të fluturimeve për të treguar manovrat akrobatike (mbi sipërfaqe ujore).

SHTOJCA 3

LIBRI I FLUTURIMIT TË PILOTIT TË DELTAPLANEVE ME VARJE DHE TË PARASHUTAVE

Libri i fluturimit të pilotit lejon atë të regjistrojë fluturimet e tij në një mënyrë konvencionale për të siguruar regjistrime permanente. Një pilot që fluturon me kategori të ndryshme mjetesh ajrore, për çdo kategori duhet të ketë një libër fluturimesh të veçantë.

1. Të dhënat në librin e fluturimeve duhet të hidhen me stilolaps ose laps, sa më shpejtë të jetë e mundur pas fluturimit, dhe të jenë të qarta.

2. Libri i fluturimit ku hidhen të dhënat për deltaplanet me varje dhe parashutat duhet të përmbajë të paktën këto informacione.

a) Informacione personale; Emri dhe mbiemri, adresa e pilotit që ka librin e fluturimit;

b) Për çdo fluturim:

- Datën e fluturimit;

- Vendin dhe kohën e ngritjes dhe të uljes;

- Tipin (modelin, tipin e variacionit) të deltaplanit me varje apo parashutës;

- Mënyrën e nisjes;

- Orët totale të fluturimit;

- Detyra gjatë fluturimit (piloti, student, instruktor, ekzaminues);

- Qëllimi dhe misioni i fluturimit;

- Distanca e fluturimit;

- Shënime dhe verifikime.

3. Libri i pranueshëm ka dimensione standarde me minimum A6 deri në A4 me mbulesë të fortë dhe me numra faqesh.



SHTOJCA 4

LICENCA E PILOTIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

TITULLI I LICENCËS

(LICENCË PILOTIMI PËR DELTAPLANE ME VARJE/ PARASHUTË)

Nr ____, Datë _____

E VLEFSHME NGA _____ DERI NË _____

Mbështetur në urdhrin e ministrit nr ____, datë _____ për miratimin e rregullores “Mbi kushtet dhe metoda e përdorimit të deltaplaneve me varje dhe të parashutave”

EMRI _____

MBIEMRI _____

KOMBËSIA _____

NR. I PASAPORTËS/ KARTËS SË IDENTITETIT _____

I JEPET LICENCA PËR _____

KLASIFIKIMI: _____

ORGANI LËSHUES

EMRI MBIEMRI

Firma/ vula

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 7.5.2012
Doli nga shtypi më 8.5.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 38 lekë